

Tiranë, më 02.06.2025

KËRKESË

KËRKUES: Partia Demokratike – Aleanca për Shqipërinë Madhështore, përfaqësuar nga Av. Marash Logu, me adresë njoftimi: Blv. Zhan D'Ark, Nr. 11, Tiranë.

OBJEKTI: Kërkesë për përjashtimin nga shqyrtimi i kërkesës ankimore me nr. 4933 prot., datë 27.05.2025 të anëtarit të Komisionit të Ankimeve dhe Sankioneve, Ilirjan Rusmali.

BAZA LIGJORE: Neni 42 i Kushtetutës së Shqipërisë;
Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
Nenet 4, 13, 30, 31 dhe 32 të Kodit të Procedurave Administrative;
Nenet 16 dhe 135 të Kodit Zgjedhor.


KOMISIONIT TË ANKIMEVE DHE SANKSIONEVE KOMISIONI QËNDROR I ZGJEDHJEVE

Të Nderuar,

Pranë Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (në vijim “KAS”), është duke u shqyrtuar çështja administrative me palë ankuese, subjekti zgjedhor “Partia Demokratike – Aleanca për Shqipërinë Madhështore” dhe me objekt: “1. Kundërshtimi i vendimit nr. 1312, datë 22.05.2025 të KSHZ “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të votimit në zonën zgjedhore Qarku Shkodër, për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin të datës 11 maj 2025”.

Në përbërje të trupës së KAS që do të shqyrtojë kërkesën ankimore me nr. 4933 prot., datë 27.05.2025, është edhe shtetasi Ilirjan Rusmali, prania e të cilit nuk garanton një proces të rregullt ligjor për palën ankuese, në drejtim të garantimit të parimit të paanshmërisë. Ky anëtar, për shkak të funksion zyrtar që mban pranë Presidentit të Republikës, si dhe vendimmarrjeve të ndërmjetme lidhur me ankimet tona të mëparshme, ashtu edhe fjalëve edhe shprehjeve që ka përdorur në raport me përfaqësuesin ligjor të ankuesit, vlerësojmë se është në kushte njëanshmërie, dhe si i tillë duhet të përjashtohet nga shqyrtimi i kërkesës ankimore, objekt shqyrtimi në këtë procedurë administrative.

Konkretisht, neni 42, pika 2, e Kushtetutës së Shqipërisë, ka parashikuar si një ndër të drejtat themelore të rangut kushtetues të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Sipas Kushtetutës, kushdo për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik, brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Për



shkak të rëndësisë së veçantë që paraqet kjo e drejtë, deri para ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, ishte e vetmja e drejtë për të cilën një individ mund t'i drejtohet drejtpërdrejt Gjykatës Kushtetuese (shih nenin 131, gërma "f"). Një ndër elementët më të rëndësishëm të së drejtës për një proces të rregullt ligjor është paanshmëria e trupës gjyquese.

Në vendimin nr. 25, datë 11.06.2023, Gjykata Kushtetuese është shprehur se *"një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet"*.¹

Ndërsa në vendimet nr. 23, datë 04.11.2008 dhe nr. 25, datë 11.06.2013 Gjykata është shprehur *"në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit që bindja personale ose interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës, dhe, gjithashtu, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtarit të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër edhe dukja e jashtme mund të ketë një farë rëndësie"*.²

Në vendimet e mësipërme të Gjykatës Kushtetuese arsyetohet se paanshmëria është një ndër elementët më të rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor. Paanshmëria e gjykatës dhe gjyqtarit duhet jo vetëm të ekzistojë, por edhe të duket së jashtmi që ekziston. Nga ana tjetër, testi subjektiv kërkon që të provohet se bindja e brendshme nuk do të ndikojë në vendimin e gjykatës, ndërkohë testi objektiv nënkupton që duhet verifikuar nëse ekzistojnë fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë.

Neni 42, pika 2 e Kushtetutës së Shqipërisë, ashtu si edhe jurisprudence e Gjykatës Kushtetuese janë në harmoni të plotë me nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, i cili parashikon gjithashtu të drejtën e çdo individi për një proces të rregullt ligjor, pjesë e të cilit sigurisht është edhe e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Ky parim i rëndësishëm është mishëruar në një sërë vendimesh të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim GJEDNJ).

Konkretisht në çështjen *Micallef v. Malta*, Gjykata ka konstatuar se testi për të provuar dyshimin legjitim bëhet mbi perceptimin objektiv të publikut. Gjykata është shprehur se *"Justice must not only be done it must also be seen to be done"*.³ Paanshmëria ka të bëjë me

¹ Vendimi Nr. 25, datë 11.06.2013 i Gjykatës Kushtetuese;

² Vendimi nr. 23, datë 04.11.2008 i Gjykatës Kushtetuese;

³ Vendimi "Micallef kundër Maltës" i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut; Vendimi "Ettstein kundër Zvicrës" i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut; Vendimi "Nicholas kundër Qipros" i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut; Vendimi "Cuber kundër Belgjikës" i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut;

mungesën e paragjykimit. Ekzistenca ose mungesa e saj mund të arrihet të shihet në një këndvështrim subjektiv, që ka të bëjë me një bindje personale ose interes personal të një gjyqtari të caktuar në një çështje konkrete dhe nën një këndvështrim objektiv, që ka të bëjë me faktin nëse gjyqtari ofron garancitë e mjaftueshme për të përjashtuar cdo dyshim të ligjshëm për ekzistencën e njëanshmërisë.⁴

Në mënyrë që të sigurohet mungesa e paragjykimit aktual, ato (gjykatat) duhet të drejtohen drejt eliminimit të cdo aparence anshmërie dhe të shërbejnë për të promovuar besimin të cilat në një shoqëri demokratike duhet të frymëzojnë tek publiku.⁵ Ndërsa në çështjen *Hauschildt v. Danimarkë*, Gjykata është shprehur se “*cdo gjyqtar për të cilin ekziston një arsye legjitime për të dyshuar mungesë të paanshmërisë duhet të dalë nga trupi gjykues*”.⁶

Këto parime themelore në një shtet të së drejtës dhe shoqëri demokratike, i gjejmë të reflektuara më tej edhe në legjislacionin e brendshëm, duke pasur parasysh se siç është shprehur Gjykata Kushtetuese, parimi i procesit të rregullt ligjor, aplikohet njësoj si në proceset gjyqësore, ashtu edhe në procedurat administrative. Konkretisht, në nenin 4, pika 2, të Kodit të Procedurave Administrative sanksionohet se “*Të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cënohen nga veprimi administrativ, përveç se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor.*”.

Më tej, në nenin 13 të KPA-së parashikohet se “*Në ushtrimin e funksioneve të tij, organi publik trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha subjektet me të cilat krijon marrëdhënie.*”. Ndërsa, neni 30 i KPA-së parashikon rastet kur një anëtar i një organi kolegjal duhet të kërkojë heqjen dorë nga një procedure administrative vendimmarrëse ose të kërkojë përjashtimi i tij. Njëri prej këtyre rasteve është i sanksionuar në nenin 30, gërma “g”, në të cilën sanksionohet se: “*Nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjal nuk përfshihet në një procedurë administrative vendimmarrëse, në rastet kur: g) nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjal, ose personat e përmendur në shkronjën “b” të këtij neni, kanë marrëdhënie të tilla, të cilat vlerësohen sipas rrethanave konkrete se do të përbënin arsye serioze për njëanshmëri me palët në procedurën administrative në shqyrtim.*”.

Duke u kthyer në rastin konkret, rezulton se në përbërje të trupës së KAS-it është edhe shtetasi Ilirjan Rusmali⁷, i cili njëkohësisht ushtron edhe detyrën e këshilltarit ligjor të Presidentit të Republikës, Barjam Begaj.⁸ Prania e këshilltarit ligjor të Presidentit në shqyrtimin e ankesave zgjedhore të subjekteve politike ngërthen një sërë problematikash të natyrës kushtetuese dhe ligjore, duke filluar që nga fakti se ndërhyrja e institucionit të Presidentit në procesin zgjedhor bien ndesh me nenin 86 të Kushtetutës, ku theksohet se “*Presidenti i Republikës është Kryetar i Shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit.*”. Përmes angazhimit të kabinetit të Presidentit të

⁴ Vendimi “Paunovic kundër Serbisë” i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut;

⁵ Vendimi “Meznaric kundër Kroacisë” i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut;

⁶ Vendimi “Hauschildt v. Danimarkë” i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut;

⁷ <https://kqz.gov.al/organet/komisioni-i-ankimimeve-dhe-sanksioneve-kas>;

⁸ <https://president.al/ilirjan-rusmali/>.

Republikës në procesin zgjedhor, çenohet rëndë parimi i neutralitetit politik dhe përfaqësimit të unitetit të popullit.

Presidenti i Republikës ka rol dhe kompetenca të kufizuara në procesin zgjedhor, siç është caktimi i datës së zgjedhjeve (shih nenin 92, gërma “gj”, të Kushtetutës), dhe pas certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve thirrjen e mbledhjes së Kuvendit të ri (shih nenin 67, pika 1), si dhe mandatin e kryeministrit të ri për formimin e qeverisë (shih nenin 96, pika 1). Për shkak të këtij roli dhe këtyre kompetencave që shtrihen në periudhën para dhe paszgjedhore, Presidenti i Republikës nuk mund t’i lejojë vetes, kabinetit apo administratës së tij, asnjë ndërhyrjeje, të çfarëdolloj natyre në procesin zgjedhor, përfshirë edhe fazën e shqyrtimit të ankesave zgjedhore.

Në të kundërt, ndërhyrja e Presidentit, përmes kabinetit të tij, në procesin zgjedhor, minon figurën e tij si Kryetar i Shtetit dhe e bën atë palë të certifikimit të një farse të plotë elektorale, siç provoi edhe Raporti Paraprak i Vëzhguesve të OSBE/ODIHR-it, ku theksohet shkrirja e shtetit me partinë në pushtet. Është e pajustificueshme që shkrirja e shtetit me partinë në pushtet të shtrihet deri tek figura e Presidentit të Republikës apo Institucioni i Presidencës, duke dëmtuar në mënyrë të pakthyeshme rolin e Presidentit si Kryetar i Shtetit – institucion kushtetues mbi palët dhe unifikues i popullit.

Pikërisht, për këtë shkak Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike i është drejtuar me një shkresë urgjente Presidentit të Republikës, duke i kërkuar mosndërhyrjen e Institucionit të Presidentit të Republikës në procesin zgjedhor dhe ruajtjen e neutralitetit politik të institucionit, pasi përfshirja aktive në procesin zgjedhor apo shkrirja e Presidencës me partinë në pushtet, përbën një atentat të rëndë ndaj demokracisë dhe vetë Kushtetutës, ku theksohet se “*Qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira dhe të barabarta*.”. Nëse partia në pushtet në procesin e certifikimit të farsës elektorale të 11 majit, ka edhe përfshirjen aktive të Presidentit të Republikës, përmes angazhimit të kabinetit të tij, atëherë vija ndarëse ndërmjet shtetit dhe partisë shkeljet në mënyrën më flagrante (*bashkëlidhur*).

Nga ana tjetër, pala ankuese nuk mund të injorojë faktin e mënyrës së zgjedhjes së Presidentit të Republikës, Bajram Begaj, i cili ka qenë një propozim i dalë nga mbledhja e Kryesisë së Partisë Socialiste në datën 3 qershor 2022, për t’u zgjedhur më pas në datën 4 qershor 2022, President i Republikës vetëm me votat e Partisë Socialiste. Propozimi dhe zgjedhja e Presidentit të Republikës vetëm me votat e Partisë Socialiste, partia në pushtet, ashtu si edhe aktet e ndërmarra në ushtrim të detyrës, krijojnë dyshime mëse të arsyeshme për njëanshmëri në e tij, ashtu si edhe të Kabinetit të tij, ku përfshihet edhe këshilltari ligjor, Ilirjan Rusmali.

Këto dyshime për njëanshmëri të shtetasit Ilirjan Rusmali, i cili paraqitet në përbërje të trupës së KAS, me petkun e dyfishtë të këshilltarit ligjor të Presidentit dhe anëtarit të KAS-it, përforcohen edhe më tej nga veprimet dhe vendimmarrjet e tij. Konkretisht, megjithëse nenet 136, 137 dhe 138 të Kodit Zgjedhor, synojnë të garantojnë të drejtën e çdo subjekti zgjedhor për të marrë çdo provë të nevojshme që i shërben shqyrtimit administrativ të ankimeve të tij, ashtu si edhe për të bërë transparencë të plotë mbi procesin zgjedhor, anëtari Rusmali refuzon

padrejtësisht dhe në mënyrë arbitrare të drejtën që ka forca kryesore e opozitës për një proces të rregullt ligjor dhe transparencë në këtë proces (siç ishte rasti i kërkesës ankimore ndaj procesit zgjedhor në Qarkun Kukës).

Po ashtu, anëtari Rusmali, në pamundësi për të kontrolluar shpërthimet emocionale dhe bindjet e tij të brendshme ndaj palës ankuese, Partisë Demokratike dhe lidërshit të saj, degradon në sharje dhe ofendime personale ndaj përfaqësuesve ligjor të subjektit zgjedhor “Partia Demokratike – Aleanca për Shqipërinë Madhështore”. Sjellje, veprime dhe shprehje, të cilat jo vetëm çenojnë solemnitetin e shqyrtimit administrativ, por dëshmojnë për probleme të thella karakteriale, siç mund të jetë mllëfi i akumuluar ndër vite i këtij anëtari ndaj Partisë Demokratike dhe lidërshit të saj, që e bën të humbasë objektivitetin dhe të mos ruajë etikën minimale të komunikimit njerëzor/institucional, që duhet të karakterizojë anëtarët e një trupe kolegjiale të një organi publik.


Prandaj, në kushtet kur anëtari i KAS, shtetasi Ilirjan Rusmali, për shkak të funksionit të tij zyrtar si këshilltar ligjor i Presidentit të Republikës, veprimeve, sjelljeve dhe vendimmarrjeve të tij në cilësinë e anëtarit të KAS-it haptazi kundër palës ankuese, subjektit zgjedhor “Partia Demokratike – Aleanca për Shqipërinë Madhështore”, dhe përfaqësuesve të saj ligjor, ka krijuar arsye serioze për njëanshmëri, në mbështetje të nenit 42, pika 2, të Kushtetutës, nenit 6, pika 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe nenit 135 të Kodit Zgjedhor, *përfundimisht*,

KËRKOJMË:

- Përgjashtimin nga shqyrtimi i kërkesës ankimore me nr. 4933 prot., datë 27.05.2025 të anëtarit të Komisionit të Ankimeve dhe Sankioneve, Ilirjan Rusmali.

PARTIA DEMOKRATIKE – ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE

Av. Marash LOGU

()



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

URGJENTE!

Tiranë, më 30/05/2025

Lënda: Kërkesë për mosndërhyrje të Institucionit të Presidentit të Republikës në procesin zgjedhor dhe ruajtjen e neutralitetit politik nga ana e institucionit Tuaj.

Drejtuar: SH.T.Z. Bajram BEGAJ
President i Republikës së Shqipërisë

Për dijeni: SH.T.Z. Ambasadorit Lamberto ZANNIER
Shef i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të ODIHR në Tiranë

I nderuar Z. President i Republikës,

Me shumë shqetësim dhe në shkelje flagrante të parimit të neutralitetit politik të Institucionit të Presidentit të Republikës, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike është njohur me faktin e përfshirjes së Kabinetit tuaj në procesin elektorale për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të 11 Majit. Sipas Kushtetutës dhe ligjit, Presidenti i Republikës dhe Institucioni i Presidentit të Republikës është organ kushtetues i pavarur, pa asnjë rol në procesin e administrimit të zgjedhjeve.

Mirëpo në kundërshtim me këtë përgjegjësi Tuajën dhe të Institucionit të Presidentit të Republikës, rezultoi e provuar përfshirja në procesin e administrimit të zgjedhjeve përmes Këshilltarit tuaj Ligjor¹ z. Ilirjan Rusmali, në rolin e anëtarit të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve. Për vetë rolin dhe përgjegjësinë që ka KAS në procesin e zgjedhjeve, mënyrës ligjore të zgjedhjes së anëtarëve të tij², si dhe procesit kushtetues të zgjedhjes së Presidentit të Republikës apo përgjegjësi të mëvonshme kushtetuese të Presidentit të Republikës lidhur me rezultatin e zgjedhjeve, angazhimi i Kabinetit tuaj në procesin e administrimit të zgjedhjeve në fazë të mëhershme³, është një ndërhyrje flagrante antikushtetuese e Institucionit të Presidentit të Republikës në zgjedhje.

¹ <https://president.al/ilirjan-rusmali/>

² Shih nenin 16 të Kodit Zgjedhor;

³ Shih nenet 67 dhe 96 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Kjo ndërhyrje e Juaja apo Institucionit të Presidentit të Republikës në procesin zgjedhor bie ndesh me nenin 86 të Kushtetutës, ku theksohet se *“Presidenti i Republikës është Kryetar i Shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit”*. Përmes angazhimit të Kabinetit tuaj në procesin e administrimit të zgjedhjeve Institucioni i Presidentit të Republikës po cënon rëndë parimin e përfaqësimit të unitetit të popullit.

Ndërhyrja juaj në procesin zgjedhor, përmes Kabinetit tuaj, minon figurën e Presidentit të Republikës dhe e bën atë palë të certifikimit të një farse të plotë elektorale, sic provoi edhe Raporti Paraprak i Vëzhguesve të OSBE-ODIHR, ku theksohet shkrija e shtetit me partinë në pushtet. Është e papranueshme që shkrija e shtetit me partinë në pushtet të shtrihet deri tek figura e Presidentit të Republikës apo Institucioni i Presidentit të Republikës. Kjo dëmton në mënyrë të pakthyeshme rolin dhe përgjegjësinë tuaj si Kryetar i Shtetit, si institucion kushtetues mbi palët politike apo si unifikuesin e popullit.

Nëse Institucioni i Presidentit të Republikës në kundërshtim me Kushtetutën ka vendosur përfshirjen aktive në procesin zgjedhor apo të shkrihet me partinë në pushtet, ky akt përbën një atentat ndaj demokracisë dhe vetë Kushtetutës, ku theksohet se *“Qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira dhe të barabarta”*. Nëse partia në pushtet në procesin e certifikimit të farsës zgjedhore ka edhe përfshirjen aktive të Institucionit të Presidentit të Republikës, përmes angazhimit të Kabinetit tuaj, atëherë vija ndarëse mes shtetit dhe partisë shkelet në mënyrën më flagrante.

Z. President i Republikës,

Në përputhje me rolin Tuaj kushtetues ju duhet të sqaroni nëse keni autorizuar përfshirjen e Kabinetit tuaj në certifikimin e “zgjedhjeve”, nëse qëndrimet e Kabinetit tuaj në sulmin publik ndaj përfaqësuesve të Partisë Demokratike në KQZ përfaqësojnë edhe qëndrimet e Presidentit të Republikës, si dhe të ndërprisni menjëherë përfshirjen/angazhimin Tuaj, përmes Kabinetit, në procesin e administrimit të zgjedhjeve, sepse sipas Kushtetutës dhe Ligjit, Institucioni i Presidentit të Republikës nuk ka asnjë përgjegjësi të këtillë. Ju keni përgjegjësinë e menjëhershme të ndërprisni shkrijen e shtetit me partinë në pushtet dhe të ruani paanësinë dhe neutralitetin politik të Institucionit të Presidentit të Republikës në procesin zgjedhor.

Duke mbetur në pritje të reagimit tuaj institucional për të ndërprerë këtë gjendje flagrante paligjshmërie,

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

KRYETARI

Gazment BARDHI

